



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.84/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.84/2025 e datës 21.01.2025

II. Partia Demokratike e Kosovës, (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,500.00€ (katërmijë e pesëqind) euro.

III. Detyrohet Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se kryetari i komunës së Skenderajt, z. Fadil Nura, gjatë ushtrimit të pozitës së tij zyrtare dhe orarit të punës, ka shfrytëzuar institucionin publik - Komunën e Skenderajt, për të promovuar kandidatët subjektit të tij politik, Partia Demokratike e Kosovës, PDK, si: z. Përparim Gruda, Ganimete Musliu, Sala Jashari, Xhevahir Geci, Mërgim Lushtaku, Blerta Deliu Kodra, Jakup Nura, Bashkim Mustafa, duke postuar disa fotografi me të njëjtin kandidatë në Facebookun e tij zyrtar me qëllim promovimi.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim, kryetari i komunës së Skenderajt, z. Fadil Nura, ka përdorur zyrën e tij me qëllim të ndikimit të votuesve për përfitimin e votave në kundërshtim me nenin 36, paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP si dhe nenin 5 dhe 6 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi për postimet në facebook.

Me datë 22.01.2025 subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka paraqitur në PZAP përgjigjen në ankesë, përmes së cilës ka kërkuar nga PZAP që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar për arsye se PDK, në momentin e vënies në dijeni për këtë rrethanë, në bazë të nenit 33, par. 6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim të evitimit të shkeljeve të pretenduara me këtë ankesë, ashtu që Kryetari i Komunës së Skenderajt menjëherë pas pranimit të njoftimit nga PDK, ka ndërmarrë masat përmirësuese, duke i fshirë të gjitha postimet të cilat janë objekt i kësaj ankese dhe duke mënjanuar në tërësi pasojat eventuale të një shkelje të tillë të pretenduar. Në rrethanat e rastit konkret, asnjëri nga kandidatët, të cilat kanë qenë pjesë e postimeve të Kryetarit të Komunës së Skenderajt, në kuptim të nenit 36 të LZP-së nuk janë nëpunës publik, për qëllime të kuptimit të nenit 36 dhe si të tillë, të njëjtit në asnjë mënyrë nuk mund të mbahen përgjegjës për veprimet e përcaktuara në këtë normë, pasi që nuk plotësojnë elementin e të qenurit nëpunës publik. Kjo për faktin se në kuptim të nenit 36 të LZP-së, është fare e qartë se nëpunësi publik nuk mund të përdor zyrën apo hapësirat e ambientit publik për qëllime të kandidaturës së tij apo të saj. Në këtë rast, kandidatët për deputetë nga radhët e PDK-së, nuk kanë shprehur asnjë qëndrim personal, me qëllim të promovimit të vetvetes për qëllime të kandidimit në zgjedhje. Po ashtu në përgjigje theksohet edhe se masat përmirësuese jo vetëm që janë ndërmarrë nga Kryetari i Komunës, por të njëjtat masa përmirësuese janë marrë edhe nga kandidatët për deputetët si më sipër, andaj kërkojmë nga PZAP, që me rastin e vendosjes meritorë mbi këtë ankesë, të konstatoj se PDK ka ndërmarrë të gjitha masat përmirësuese me qëllim të evitimit të pasojave të shkeljeve të pretenduara me këtë ankesë.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur si provë CD me video incizime të fshirjes së postimeve përkatëse nga Kryetari i Komunës dhe kandidatët për deputet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

-Ankesa është e bazuar

Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së subjektit politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kryetarit të Komunës së Skenderajt, z. Fadil Nura është shkelur neni 36 i LZP i cili përcakton: *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje, dhe neni 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, i cili përcakton: "Nëpunësit civil që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, për qëllime të fushatës së zgjedhjeve, ju ndalohen veprimet në vijim, siç përcaktohet me nenin*

36 të LZP: 1.1. Përdorimi i zyrës dhe çfarëdo infrastrukture apo pasurie të saj, me qëllim të përfitimit të votës”, pasi që kryetari në fjalë me qëllim të promovimit të kandidatëve të subjektit të tij politik PDK, ka shfrytëzuar institucionin publik - Komunën e Skenderajt, për të promovuar kandidatët e subjektit të tij politik PDK.

Kështu që paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj promovimi i kandidatëve të subjektit të tij politik PDK, duke shfrytëzuar institucionin publik - Komunën e Skenderajt, përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë ka marrë për bazë faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë përpjekje dhe ka fshirë postimin nga rrjeti social Facebook, por se njëkohësisht në lartësinë e dënimit me gjobë është marrë për bazë fakti se subjekti i njëjtë politik ka bërë të njëjtën shkelje dhe për këtë është dënuar me vendimet e Panelit me numër Anr.61/2025, Anr.63/2025 dhe Anr.69/2025.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.84/2025 më datën 23.01.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.